



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:086199
Datë: 05.02.2021
Numri i dokumentit: 01479776

C.nr.255 /19

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Malsor Kryeziu, me praktikanten e kësaj gjykate Liridona Uka, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Z. M., nga Gjakova, rr. “. . .” hyrja . . ., të cilën e përfaqëson i autorizuari Ilir Rogova, avokat nga Gjakova, kundër të paditurës Universiteti i Gjakovës “. . .” – Gjakovë, të cilin me autorizim e përfaqëson H. M., zyrtar Ligjor, me objekt të padisë kompensimin e pagave me rastin e pensionimit dhe shpërblimin jubilar, vlera e kontestit 4.655.97 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 19.01.2021, i përpiluar me dt.05.02.2021, morri këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Z. M., nga Gjakova dhe **DETYROHET** e paditura Universiteti i Gjakovës “. . .” në Gjakovë, që paditësit të ia paguaj borxhin në emër të tri pagave me rastin e pensionimit në shumën prej 3,103.98 euro si dhe në emër të shpërblimit jubilar 150 % të një pagë bazë në shumën prej 1,486.41, euro, e në shumën e përgjithshme prej 4.590.39 euro, e këto me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke llogaritur nga data e marrjes së këtij Aktgjykimi 19.01.2021, e tutje deri në pagimin definitiv, e krejt këto në afatin prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

II. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit Z. M., nga Gjakova, për borxhin në emër të tri pagave me rastin e pensionimit dhe shpërblim jubilar mbi shumën e aprovuar si në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi, e deri në shumën e kërkuar si në precizim të kërkesëpadisë, refuzohet si e pa bazuar.

III. DETYROHET e paditura që t’ia paguajë paditësit shpenzimet procedurale dhe atë në lartësi prej 310.40 euro në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi në këtë Gjykatë me dt.03.04.2019, ka parashtruar padi kundër të paditurës Universiteti i Gjakovës “. . .” në Gjakovë, me objekt të padisë kompensimin e tri pagave mujore me rastin e pensionimit dhe kompensimin e shpërblimit jubilar. Në referat të padisë ka theksuar se paditësi ka qene në marrëdhënie të rregullt të punës tek e paditura Universiteti i Gjakovës “. . .

.”, dhe ka punuar në cilësinë e mësimdhënësit, deri në kohën e pensionimit. Pas pensionimit paditësit ka takuar e drejta në tri paga me rastin e pensionimit dhe në shpërblim jubilar. Bazën juridike të padisë e përbënë Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar të dt.18.04.2017, neni 35.8 dhe 35.9. Meqenëse e paditura refuzon që të paguaj shumën e të hollave në emër të pagave për përcjellje në pension dhe shpërblimin jubilar paraqes këtë padi dhe I propozoj gjykatës që pas zhvillimit të procedurës të merr aktgjykim të aprovohet kërkesëpadija dhe të detyrohet e paditura që paditësit t’ia kompensoj tri paga mujore me rastin e pensionimi dhe shpërblimin jubilar në shumën e përgjithshme prej 4.655.97 euro me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së kësaj padie si dhe të ja kompensoj shpenzimet procedurale të gjitha në afat prej 15 ditësh pasi ky Aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarimit.

I autorizuari i paditësit në seancën kryesore ka deklaruar se mbetëm pranë padisë dhe deklarimeve të bëra në seancën përgatitore. Ndërsa në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se paditësi ka iniciuar kërkesë jashtë gjyqësore për ta ekonomizuar procedurën por që kërkesa e tij nuk është përmbushur dhe të njëjtit është obliguar që të inicioj këtë kontest gjyqësor. Gjatë fazës së shqyrtimit përgatitor paditësi ka bërë zgjerimin e kërkesëpadiës në aspektin objektiv si dhe ka plotësuar shkresat e lëndës me prova të cilat kanë rendësi vendimtare në themelësinë e kërkesëpadiës. Për këtë pala e paditur ka pasur kohë të mjaftueshme që ta kundërshtoj dhe të deklarohet por që nuk ka sjellë prova të mjaftueshme për ti kundërshtuar perëndimet e paditësit. Sa i përket vendimit të të paditurës mbi daljen në pension të këtu paditësit dëshirojmë që ta bëjmë ndryshimin në mes të procedurës administrative dhe kontestit nga marrëdhënia e punës. Paditësi ndënjëse ka lëshuar afatin 8 ditor, të ankesës për vendimin e shkuarjes në pension kurrsesi nuk mund të pretendohet se i është parashkruar kërkesa nga marrëdhënia e punës e cila realizohet në procedurë kontestimore. Sa i përket pretendimeve se kontrata kolektive gjen zbatim vetëm për arsimin para universitar i njëjti është pretendimi i pa bazuar sepse vetë kjo kontratë me nenet e saj 1 dhe 2 përcakton qëllimin dhe fushë veprimtarin e gjer të kësaj kontrate e cila ndër të tjera përfshinë edhe këtu të paditurën si punëdhënëse për këtu paditësin. Nga të gjitha provat të cilat u administruan nga gjykata në seancën e sodit në mënyrë të pa dyshim i vërtetua se palët ndërgjyqëse kanë qenë në marrëdhënie pune u vërteta nga anëtarësia e paditësit në sindikatë përvoja e punës, si dhe lartësia e kërkesëpadiës. Prandaj gjykatës i propozoj që kërkesëpadiinë ashtu siç është precizuar në seancën për shqyrtimin përgatitor ta aprovoj në tërësi si të bazuar. Përpos kryegjësë paditësi sipas padisë burimore ka kërkuar edhe kamatën 8 % dhe atë e njëjta të rrjedhë që nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën dëfteve për shkak se konform 305 zë LMD-ës, e paditura ka rënë në vonesë prej atij momenti kur është thirrur për ta përmbushur detyrimin. Po ashtu i kërkojmë shpenzimet procedurale dhe atë pagesa e taksës gjyqësore në lartësi 40.00 euro, si dhe përfaqësimi në 2 seanca secila nga 135.20 euro, përkatësisht shuma e përgjithshme 310.40 euro, ta kompensoj të njëjtën në afat prej 15 ditësh, nën kërcënimin e përmbarimit, kontrata kolektive e arsimit është dokument që prodhon efekt juridik në tërë R. e Kosovës, dhe përfshirë këtu edhe për 2 palët ndërgjyqëse është fakt notar i njohur se Universiteti “. . .” është universitet shtetëror publik, prandaj edhe paditësi e ka kërkesën e bazuar në lidhje me realizimin e të drejtave sipas kontratës kolektive. E paditua ndoshta edhe mund të ketë ndonjë kontest tjetër me Ministri apo Qeveri në lidhje me rimbursimin e kërkesave të këtu paditësit por që në këtë moment dhe në këtë çështje kontestimore paditësi nuk mund të pësoj nga ky mos koordinim i ish punëdhënësit të tij (e paditur) me Ministrinë e Arsimit.

E paditura në përgjigje në padi të dhënë me dt.24.07.2019 ka theksuar duke qenë se padinë e tillë të paraqitur në Gjykatën Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, brenda afatit ligjor e paditura paraqet këtë përgjigje në padi. E paditura e kundërshton në tërësi padinë e paditësit si të pa bazuar. Nuk është kontestues fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, në vendin e punës Ligjërues i perkohshëm në Fakultetin

e Filozofisë në Universitetin e Gjakovës “. . .”, nga dt.01.05.2015, ku paditësi e ka mbushur moshën e pensionimit me dt.22.01.2018 dhe të njëjtit në bazë të vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.03/13 të dt.27.03.2018 i është vazhduar kontrata e punës deri në përfundim të vitit akademik përkatësisht deri me 30 shtator 2018. Sa i përket kërkesës për pagesën e pagave për përcjellje në pension dhe shpërblimin jubilar paditësi kërkesën e vet e mbështet në Kontratën Kolektive të Arsimit të Kosovës Nr.01B-2056 të dt.18.04.2017, e lidhur në mes MASHT dhe SBASHK. E paditura konsideron se sipas dispozitave ligjore të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e pensionimit të paditësit të drejtat dhe detyrat e personelit mësimor në sistemin arsimor janë rregulluar me Ligjin e Punës Nr.03/L-2012 dhe kz Ligj nuk ka paraparë beneficione apo privilegje për personat të cilëve u ndërpritet marrëdhënia e punës sipas fuqisë ligjore me mbushjen e moshës së pensionimit. Ligji i Punës përmban dispozita ligjore përkatëse të cilat ceket marrëveshja kolektive duke mos imponuar detyrim ligjor për zbatimin e saj. Neni 90 pika 5 e Ligjit të punës i ka lënë në diskrecion për zbatimin ose jo të një marrëveshje të tillë dhe është çështje e vullnetit të lirë të punëdhënësve dhe punëmarrësve. E paditura nuk ka nënshkruar asnjë kontratë kolektive dhe kjo kontratë nuk mund të jetë bazë për detyrimin e të paditurës sepse e paditura nuk ka dhënë miratimin e për një kontratë të tillë. E paditura nuk ka ndonjë dëshmi se ndonjëri nga anëtarët e personelit të saj të rregullt mësimor ka qenë anëtarë i SBASHK-ut. Aplikimi i Kontratës Kolektive ka implikime financiare dhe kërkon ndarje buxhetore për zbatimin e saj. Qeveria e R. Kosovës, nuk ka paraparë buxhet dhe nuk ka ndarë mjete financiare për asnjë institucion publik për qëllim të zbatimit të saj. Ka propozuar refuzimin e kërkesëpadisë sio të pa bazuar.

I autorizuari e të paditurës në seancën kryesore ka deklaruar mbesim pranë përgjigjes në padi njëherit shtoj se e kontestojmë bazën ligjore të kërkesëpadisë për kompensimin e shpërblimit jubilar me rastin e daljes në pension, edhe pse nuk është kontestuese se kontrata e punës mes paditësit dhe të paditurës nga 1 tetor 2015, deri me 22 janar 2018, kur paditësi ka arritur moshën e pensionimit dhe të njëjtit sipas vendimit të Qeverisë nr.03/13 dt.27.03.2018, i është vazhduar kontrata e punës deri me 30 shtator 2018 (deri në përfundim të vitit akademik). Me kontratën e punës nr.01/2337 dt.1 tetor 2015, nuk është përcaktuar se paditësit i takon e drejta e kompensimit pas pensionimit sipas kontratës kolektive po ashtu në bazë të vendimit të paditurës me nr.01/55 dt.19 janar 2018, paditësi është njoftuar për plotësimin e kushteve ligjore të punësimit dhe në atë vendim nuk është përcaktuar se i takon e drejta e kompensimit pas pensionimit. Gjithashtu në këtë vendim paditësi i është dhënë këshillë juridike që në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit se a pajtohet me kushtet e pensionimit apo jo, ndërsa paditësi ka parashtruar kërkesë të e paditura me 7 mars 2019, çka nënkupton se jo vetëm që nuk ka shfrytëzuar afatin e këshillës juridike por i njëjti kërkesën e ka bërë edhe jashtë afati të përcaktuar me ligjin me procedurën e përgjithshme administrative. Pavarësisht se e paditura konsideron se të drejtat e tyre të personelit arsimor në sistemin arsimor në kohën e pensionimit të paditësit janë rregulluar me ligjin e punës, dhe ky ligj nuk ka paraparë kompensimi pas pensionimit. Po ashtu me ligjin në fjalë në nenin 90 pika 5, është përcaktuar se marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive. E paditura nuk ka marr për sipër detyrimet e përcaktuar në këtë marrëveshje as me kontratë pune apo me ndonjë akt tjetër. Kontrata kolektive e arsimit me shumë ka të bëjë me mësimdhënës para universitar dhe jo me ata universitar duke pas parasysh se stafi akademik dhe e paditura kontratën e punës e lidh konform dispozitave të akteve juridike në bazë të cilave funksion universiteti i Gjakovës, e që janë ligji për arsimin e lartë dhe statuti i universitetit. Prandaj kjo kategori edhe pse arrin moshën e pensionimit brenda afatit akademik ju vazhdohet kontrata e punës deri në përfundim të vitit akademik, me kushte të njëjta dhe pagë të njëjtë. E paditura nuk ka qenë nënshkruese e kontratës kolektive të arsimit dhe kjo kontratë nuk mund të ketë autoriteti juridik me lartë se vetë ligji. E paditura po ashtu kundërshton lartësinë e kërkesëpadisë për shkak se në llogaritjen e pagave përcjellëse në pension dhe pagesës së

shpërblimit jubilar nuk është marr për bazë paga bazë e paditësit por të ardhurat duke përfshirë edhe shtesat në pagë. Kërkojmë nga gjykata që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit si e pa bazuar. I autorizuari i të paditurës në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se nga padia apo precizimi i padisë dhe parashtrimet në këtë seancë nuk është vërtetuar baza ligjore e kërkesëpadisë e paditura konsideron se e drejta dhe detyrimet e personelit arsimon në sistemin arsimor janë të rregulluara me ligjin e punës dhe ky ligj nuk ka paraparë asnjë kompensim me rastin e përcjelljes në pension apo kompensim pagese për shpërblimin jubilar. Ligji i punës përmban edhe dispozitat me të cilat ceket përkatësisht në nenin 90 pika 5 të këtij ligji, “marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara nga sa kam theksuar dhe në përgjigje në padi dhe në parashtrimet në seancë i propozoj gjykatës që të refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: vendimin e lëshuar nga Universiteti “. . .” në Gjakovë, me numër të protokollit 01/55 dt.19.01.2018, vendimin e lëshuar nga Universiteti i Gjakovës “. . .” me numër të referencës 01/1800 dt.10.08.2015, kërkesa e ushtruar nga paditësi Z. M., për të paditurën UGJ “. . .” e protokolluar me numër 279 dt.07.03.2019, vërtetimin e lëshuar nga SHMU “Yll Morina/” në Gjakovë me dt.11.03.2019, e nënshkruar nga drejtori B. B., njoftimin e lëshuar nga Universiteti i Gjakovës “. . .”, Ref. Nr.03/41 dt.26.02.2019, i nënshkruar nga sekretari i përgjithshëm L. D. H., vërtetimin e lëshuar nga shkolla Yll Morina në Gjakovë dt.28.02.2019 me numër të protokollit 2157/19, vërtetimin e lëshuar nga SHFMU “Zekeria Rexha” me dt.27.02.2019, vërtetim i lëshuar nga SHMU “Mazllum Këpuska”, nr.21/2019, dt.27.02.2019, vërtetimin e lëshuar nga konvikti i nxënësve dhe studentëve në Gjakovë dt.28.02.2019, kopjen e listave të pagave të lëshuar nga Buxheti i R. Kosovës, pasqyrën e llogarisë bankare e lëshuar nga ProCredit Bankë me dt.16.12.2020 në emër të paditësit Z. M., vërtetimin e lëshuar nga SBASHK-u, nr.1524/1 dt.14.12.2020, kopjen e vërtetuar të librezës së punës me numër serik 91450, dhe me numër të regjistrimit 26799, e paditësit Z. M., kontratën e punës e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës me numër të referencës nr.01/2337 e dt.01.10.2015.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar.

Nga provat e administruara në mënyrë të gjithmbarshme, gjykata ka vërtetuar faktin se nuk është kontestuese në mesë palëve se paditësi për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension, e paditura me përgjigje në padi dhe në seanca, nuk i ka kontestuar pretendimet në padi nga ana e paditësit se ka përvojën të punës në arsim mbi 40 vite dhe se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, në vendin e punës Ligjërues i përkohshëm në Fakultetin e Filozofisë në Universitetin e Gjakovës “. . .”, nga dt.01.05.2015, ku paditësi e ka mbushur moshën e pensionimit me dt.22.01.2018 dhe të njëjtit në bazë të vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.03/13 të dt.27.03.2018 i është vazhduar kontrata e punës deri në përfundim të vitit akademik përkatësisht deri me 30 shtator 2018. Paditësi Z. M. ka qenë anëtarë i i SBASHK-ut, deri në Pensionim. I njëjti në tre muaj e fundit para pensionimit ka realizuar page mujore 1.034,66 euro, ndërsa paga bazë e paditësit ka qenë 990.94 euro.

Paditësi Z. M., me parashtrësë në formë të shkruar, ka kërkuar nga e paditura Universiteti i Gjakovës “. . .”, pagesën e pagave për përcjellje në pension si dhe pagesën e shpërblimit jubilar,

mirëpo e paditura nuk i është përgjigjur dhe nuk i ka kompensuar borxhin e kërkuar në emër të tri pagave me rastin e pensionimit si dhe shpërblimin jubilar.

Sa i përket bazës së kërkesë-padisë, Gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka qenë i punësuar tek e paditura, në vendin e punës Ligjërues i përkohshëm në Fakultetin e Filozofisë në Universitetin e Gjakovës “. . .”, nga dt.01.05.2015, ku paditësi e ka mbushur moshën e pensionimit me dt.22.01.2018 dhe të njëjtit në bazë të vendimit të Qeverisë së Kosovës nr.03/13 të dt.27.03.2018 i është vazhduar kontrata e punës deri në përfundim të vitit akademik përkatësisht deri me 30 shtator 2018, andaj paditësi me rastin e pensionimit ka kërkuar nga e paditura kompensimin e tri pagave me rastin e pensionimit dhe shpërblimin jubilar, ndërsa e paditura nuk i është përgjigjur kërkesës së paditësit, andaj duke u bazuar në dispozitat ligjore tek Kontrata Kolektive të Arsimit në Kosovë e dt.18.04.2017, e cila kontratë po me këtë datë ka hyrë në fuqi, sipas së cilës me dispozitat e nenit 35.8 ku citohet se *“Punëtorët që dalin në pension përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë: 8.1 për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë 50% të një page bazë. 8.2 për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë 75% të një page bazë. 8.3 për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë. 8.4 për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150% të një page bazë. 8.5 Shpërblimet jubilarë paguhen nga punëdhënësit ku i punësuarit ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse”*. Dhe më tutje, sipas dispozitave të nenit 35.9 *“Punëtorët (që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri (3) pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit”*. Duka marr parasysh rrethanat e lartcekura Gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, pasi që me rastin e daljes së paditësit në pension me dt.22.01.2018 ka qenë në fuqi kontrata e sipër cituar e cila ka hyrë në fuqi me dt.18.04.2017, andaj paditësit ia ka aprovuar pjesërisht lartësinë e kërkesëpadisë sa i përket tri pagave për përcjellje në pension shumë prej nga 1.034,66 euro për një pagë x 3 shumë e përgjithshme prej 3,103.98 euro, në kuptim të nenin 35.9 të Kontrata Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017 si dhe 150 % të një page bazë të pagës së fundit në shumë prej 1,486.41 €, në kuptim të nenin 35.8 pika 8.4 ku për mbi 40 vite të përvojës së punës në vlerë 150% të një page bazë, për shkak se kjo Gjykatë vërtetoi faktin se paditësi tek punëdhënësi – e paditura është pensionuar dhe i ka mbi 40 vite përvojë pune, çka do të thotë se kërkesë-padie e paditësit është aprovuar pjesërisht në shumë e përgjithshme prej 4.590.39 euro (katërmijë e pesëqind e nëntëdhjetë euro e tridhjetë e nëntë cent).

Gjykata vlerëson se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, është në fuqi dhe e zbatueshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe se ky dokument kontraktual, prodhon efekt juridik ndaj palëve në procedurë të cilat janë të legjitimuara në kuptimin e legjitimitetit real aktiv dhe pasiv në këtë çështje juridike.

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*. prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditorit, përkatësisht këtu paditësit në rastin konkret, të i paguajë vlerën e precizuar të kërkesëpadisë si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç më detalisht është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese respektivisht shumës mbi shumën e aprovuar, për 3 paga për përcjellje në pension, gjykata ka marrë parasysh faktin se paditësi ë tre muaj e fundit para pensionimit ka realizuar page mujore 1.034,66 euro x 3 shumën e përgjithshme prej 3,103.98 euro, e jo siç e ka precizuar i autorizuari i paditësit shumën prej €233.94 euro, po ashtu edhe për shpërblimin jubilar gjykata të njëjtën e refuzoi pjesërisht ngase konsideroi se shuma e kërkuar mbi shumën e aprovuar është mbi shumën e cila është e paraparë me dispozitat ligjore të kontratës kolektive, paga bazë e paditësit ka qenë 990.94 euro. Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vlerëson se shuma e kërkuar me kërkesëpadi përtej shumës së aprovuar për shpërblim jubilar, nuk është reale dhe se është në kundërshtim me dispozitat e kontratës kolektive të arsimit në Kosovë e dt.18.04.2017, konkretisht neni 35.8 pika 8.4 i kontratës.

Gjykata vlerësoj pretendimet e palës së paditur, mirëpo pretendimet e tilla nuk qëndrojnë për faktin se Gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka dal në pension me dt.22.01.2018, ndërsa Kontrata Kolektive të Arsimit në Kosovë e dt.18.04.2017 është e lidhur mes Ministrisë së Arsimit dhe SBASHK-ut, e cila kontratë ka hyrë në fuqi me dt.18.04.2017, me dispozitat e saj me nenet 1, dhe 2, në mënyrë decisive është paraparë qëllimi i marrëveshjes, fushëveprimi i saj dhe aplikimi dhe përfshirja, po ashtu lidhur me planifikimin e buxhetit për pagat e tilla pala paditëse nuk është fajtor lidhur me planifikimin e buxhetit pasi që më këtë merren organet shtetërore, andaj pretendimet të tillë kjo Gjykatë nuk e mori parasysh duke i konsideruar të njëjtat pa ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes, nga se nuk kishin mbështetje ligjore.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerrë konform nenit 452.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
C.nr.255 /19, me datë.05.02.2021

Gjyqtari
Malsor Kryeziu

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.